



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 18, Datë 06.02.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 06.02.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/6 prot, datë 03.02.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes “Mbi licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 21.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.12.2022 dhe 24.12.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 01.01.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Duke qenë se nga korrespondencat me shoqërinë, u konstatua mungesë e vërtetimit të gjendjes gjyqësore për administratorin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., (dokument që lëshohet nga një organ tjetër), Bordi i ERE-s në zbatim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pezulloi me 10 ditë pune vendimmarrjen e tij në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për t’i dhënë mundësinë shoqërisë të depozitojë këtë dokument.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI